

PROCESI I HARTIMIT TË PROJEKTLIGJEVE NGA QEVERIA E KOSOVËS

Politik-bërja mund të përkufizohet si proces përmes të cilit qeveria synon të bëjë shndërrimin e vizionit të saj politik në programe dhe veprime konkrete. Strategjitë, ligjet, aktet nënligjore, dhe dokumentet tjera qeveritare janë instrumente përmes të cilave materializohet një politikë e caktuar.

Në Kosovë, funksioni legjislativ i takon Kuvendit të Kosovës. Mirëpo në praktikë pjesa dërrmuese e ligjeve hartohen nga Qeveria, për t'u adoptuar pastaj nga Kuvendi. Kushtetuta e Kosovës, të drejtën për nisma ligjore e garanton për Presidentin e Republikës së Kosovës – nga fushë veprimtaria e vet, deputetët e Kuvendit, Qeverinë, dhe 10000 qytetarë. Në praktikë, Qeveria e Kosovës është nismëtari apo sponsorizuesi i shumicës së ligjeve të hartuara.

PROCESI I HARTIMIT TË PROJEKTLIGJEVE NGA QEVERIA

Procesi i hartimit të ligjeve nga ana e Qeverisë definohet përmes Rregullores së Punës të Qeverisë, si dhe me një numri të akteve tjera normative. Të gjitha këto e obligojnë Qeverinë që secilin ligj ta hartojë duke kaluar nëpër disa faza. Poashtu, kjo Rregullore parasheh që projektligjet e reja, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese, aktet e rëndësishme nënligjore si dhe propozimet tjera që kanë ndikim të konsiderueshëm social ose ekonomik duhet të paraprihen me Koncept Dokument. Ndërkaq, të drejtën për të iniciuar hartimin e ligjeve e gëzojnë Kryeministri, Ministrat, Sekretarët e Përgjithshëm, Kryeshefat e Agjencive Ekzekutive dhe Drejtorët e Departamenteve.

FAZAT E HARTIMIT TË PROJEKTLIGJEVE

HARTIMI PARAPRAK I PROJEKTLIGJIT

Varësisht prej organit propozues – e që në shumicën e rasteve janë ministrinë – bëhet themelimi i grupit punues në kuadër të ministrisë. Grupi punues harton draftin fillestar të projektligjit. Gjatë kësaj faze, diskutohen të gjitha mundësitë dhe alternativat për adresim të çështjeve të caktuara përmes ligjit, konceptohet korniza e përmbajtjes së projektligjit si dhe strukturimi i përmbajtjes në kapituj, nene dhe pika. Anëtarët e grupit punues në të shumtën e rasteve janë vetëm zyrtarët qeveritarë. Rrallë ndodhë që qysh në fazën e hartimit paraprak të projektligjit të përfshihen edhe hisedarë tjerë, si, përfaqësues të shoqërisë civile, bizneseve apo grupeve tjera të interesit.

KONSULTIMI PARAPRAK NË MES TË AUTORITETEVE QEVERTARE

Pasi organi propozues ta ketë hartuar draftin e parë të projektligjit, ministrinë, agjencinë dhe organet tjera qeveritare relevante ftohen të vlerësojnë nëse sektori të cilin e mbulojnë ndikohet nga ligji në fjalë, rrjedhimisht të komentojnë përmbajtjen e draftit të hartuar nga organi propozues.

KONSULTIMI PUBLIK

Pasi që projektligji të jetë avancuar edhe me komentet e organeve tjera qeveritare dhe agjencive ekzekutive, ai ndahet për konsultim me hisedarët tjerë, përkatësisht palët të cilat preken drejtpërdrejtë apo tërthorazi nga projektligji, si: qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, bizneset apo grupet tjera të interesit. Në këtë fazë të hartimit të ligjeve, organi propozues obligohet që të ofrojë informata të mjaftueshme dhe të qarta rreth projektligjit, në mënyrë që palët e konsultuara të kuptojnë ndikimin dhe pasojat që dalin nga projektligji. Afati kohor minimal për këtë fazë është 15 ditë pune. Më pas, organi propozues bën shqyrtimin e komenteve dhe përfshirjen e tyre në projektligj.

Koncept Dokumenti është material analitik përmes të cilit adresohet nevoja për një politikë të caktuar. Koncept dokumenti duhet të përmbajë çështjen e cila i dërgohet Qeverisë për vendim, alternativat e propozuara për adresim të politikës, arsyeshmërinë e alternativave të propozuara, ndikimin e alternativës së rekomanduar – *përfshirë, koston financiare, ndikimet e pritura të politikës te grupet e synuara, harmonizimin me parimet themelore të legjislacionit të BE-së* – dhe forma e komunikimit të politikës nga ana e Qeverisë.

Format më të zakonshme, të përdorura në Kosovë janë, konsultimet me shkrim dhe takimet me hisedarë.

Konsultimet me shkrim – proces i konsultimit të hisedarëve përmes kontributeve me shkrim. Qeveria e Kosovës, pasi ta ketë hartuar draftin e parë të projektligjit fton organizatat e shoqërisë civile, dhe hisedarët tjerë për kontribute me shkrim rreth përmbajtjes së projektligjit. Afati minimal për dërgim të kontributeve me shkrim është 15 ditë pune. Së bashku me projektligjin, organi propozues – Ministria – duhet të dërgojë një dokument shpjegues përmes të cilit komunikohet përmbajtja e projektligjit në gjuhë të kuptueshme për publikun e gjerë, dhe materiale tjera relevante që lehtësojnë kuptimin e përmbajtjes së projektligjit.

Takimet me hisedarë – proces i konsultimit të hisedarëve përmes takimeve të drejtpërdrejta. Në këtë lloj konsultimi, organi propozues fton hisedarët për takim konsultativ, me ç'rast bëhet prezantimi i projektligjit dhe debatohen çështjet me interes të hisedarëve, propozohen çështje të reja për tu përfshirë në projektligj etj.

SHQYRTIMI DHE MIRATIMI I PROJEKTLIGJIT NGA QEVERIA

Pasi që projektligji të ketë kaluar fazën e konsultimit publik, Departamenti Ligjor i organit propozues bën harmonizimin e projektligjit me dispozitat ligjore dhe kushtetuese. Më pas, projektligji dërgohet tek Ministri për miratim. Në rast të vërejtjeve apo komenteve shtesë, Ministri mund ta kthejë projektligjin për plotësim tek grupi punues. Nëse Ministri jep pëlqimin për përmbajtjen e projektligjit, ai dërgohet për procedim të mëtejshëm në Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Integritimit Europian.

Ministria e Financave bën vlerësimin e kostos financiare të projektligjit, përkatësisht vlerëson nëse Qeveria mund ta përballojë koston financiare të zbatimit të projektligjit. Dokumenti përmes të cilit jepet ky pëlqim është Deklarata mbi Ndikimin Buxhetor. Ministria e Integritimit Europian vlerëson nëse projektligji është në përputhshmëri me parimet themelore të legjislacionit të BE-së, të njohura si Acquis e BE-së. Dokumentet përmes të cilëve jepet ky pëlqim janë Deklarata e Përputhshmërisë dhe Tabela e Përputhshmërisë me Acquis të BE-së.

Çdo projektligj i cili dërgohet përmes Zyres Ligjore të ZKM-së për miratim nga Qeveria duhet të jetë në tri gjuhë, gjuhë shqipe, serbe dhe angleze.

Pakoja e plotë e projektligjit dërgohet për miratim përfundimtar tek Ministri përkatës. Në rast se Ministri nuk ka komente shtesë rreth projektligjit, ai dërgohet për procedim të mëtejshëm në Zyren Ligjore të Zyres së Kryeministrit. Si hap përfundimtar brenda organeve të Qeverisë, projektligji dërgohet për diskutim dhe miratim në mbledhjen e Qeverisë.

Pasi që projektligji të jetë miratuar në mbledhjen e Qeverisë, ai dërgohet për procedim të mëtejshëm në Kuvendin e Kosovës. Pas adoptimit nga Kuvendi, projektligji dërgohet për dekretim te **Presidenti i Kosovës**. Dhe krejt në fund, projektligji publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

ORARI I PUNËS
 e hënë – e premte
 10:00 deri 14:00



Qendra ofron si dhe i përgjigjet çdo kërkesë për informacion për nevojat e organizatave të shoqërisë civile (OShC), qytetarëve të interesuar, institucioneve publike dhe organizatave donatore për zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë.

QËLLIMI I QENDRËS:

- Ngritja e kuptimit mbi rolin e shoqërisë civile në demokratizimin e vendit
- Ngritja e kuptimit mbi rolin e shoqërisë civile në procesin e politikë-bërjes dhe vendim-marrjes
- Grumbullimi dhe shpërndarja e informacionit rreth sektorit të shoqërisë civile
- Krijimi i instrumenteve për mbledhjen dhe analizën e vazhdueshme të të dhënave për sektorin e shoqërisë civile dhe fusha të veçanta të këtij sektori
- Ngritja e kapaciteve të OShC-ve dhe institucioneve publike për bashkëpunimin ndërsektorial
- Promovimi dhe përkrahja e drejtpërdrejtë në qeverisjen e mirë të brendshme të OShC-ve

ÇKA OFRON QENDRA?

- **Deskun e informacionit** i cili i përgjigjet çdo kërkesë për informacion rreth sektorit të shoqërisë civile dhe pranon kërkesat e OShC-ve për trajnime, përkrahje dhe mentorim
- **Trajnime bazike dhe të avancuara** për pjesëtarët e OShC-ve, në baza të rregullta ose në bazë paraqitjes së kërkesës nga ana e OShC-ve
- **Shërbimin e këshillimit gjatë punës dhe mentorimit** që ofron këshillim dhe mentorim në punën e përditshme të OShC-ve në bazë të kërkesës së tyre
- **Këndin e informacionit** ku vizitorët mund të marrin informata rreth sektorit të shoqërisë civile dhe broshura e artikuj informues për këtë sektor
- **Këndin e leximit** që mund të presë deri në 10 vizitorë
- **Këndin e bibliotekës** ku vizitorët mund të gjejnë libra dhe artikuj nga fusha e zhvillimit të shoqërisë civile dhe procesit të integritimit evropian
- **Sallën** e pajisur me të gjitha elementet me kapacitet deri në 25 persona

CILAT JANË RREGULLAT PËR VIZITORË?

Broshurat dhe fletushkat jepen falas për të gjithë vizitorët

Librat, buletinet dhe publikimet tjera mund të lexohen vetëm brenda Qendrës

Të gjithë të interesuarit për shërbimet e Qendrës duhet të kontaktojnë deskun e informacionit, me shkrim apo drejtpërdrejtë